



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financiare dhe Monitorimit të Fushatës**  
**Sektori për Subjektet Zgjedhore dhe Mandatet**

|          |  |
|----------|--|
| Data     |  |
| Nr. Prot |  |

**RELACION**

**VENDIMI**

**PËR**

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE**  
**PËR KRYETAR TË BASHKISË BERAT, QARKU BERAT, NË ZGJEDHJET E**  
**PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE, NË DISA NJËSI TË QEVERISJES**  
**VENDORE, TË DATËS 9 NËNTOR 2025**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Në mbështetje të Dekretit nr. 350, datë 01.10.2025 të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie, të datës 9 nëntor 2025.

Bashkia Berat ka 2 (dy) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 66 dhe ZAZ nr. 67.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat.

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

ZAZ nr. 66 dhe ZAZ nr. 67, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi për kryetarin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore për Kryetarin e Bashkisë Berat, u kontrolluan tabelat përmbledhëse përkatësisht ZAZ nr. 66 dhe ZAZ nr. 67, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve çdo QV-je të zonës zgjedhore.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Berat, Qarku Berat, në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025”.

**Pavlina DOÇAJ** -Drejtorja e Ligjshmërisë

**Licela VELIU** - Drejtorja e Përgjithshme për Koordinimin dhe Mbështetjen

**Jona JOSIFI** -Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data:

Nr:

Ora:

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE**  
**PËR KRYETAR TË BASHKISË BERAT, QARKU BERAT, NË ZGJEDHJET E**  
**PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE, NË DISA NJËSI TË QEVERISJES**  
**VENDORE, TË DATËS 9 NËNTOR 2025**

Sot më datë 00.11.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim çështjen me:

**Objekt:** Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Berat, Qarku Berat, në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025.

**Baza ligjore:** Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

**V Ë R E J:**

Në mbështetje të Dekretit nr. 350, datë 01.10.2025 të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie, të datës 9 nëntor 2025.

Bashkia Berat ka 2 (dy) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 66 dhe ZAZ nr. 67.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat.

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Data:

Nr:



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Berat, Qarku Berat në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025”

ZAZ nr. 66 dhe ZAZ nr. 67, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi për kryetarin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore për Kryetarin e Bashkisë Berat, u kontrolluan tabelat përmbledhëse përkatësisht ZAZ nr. 66 dhe ZAZ nr. 67, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve çdo QV-je të zonës zgjedhore.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të z. Ervin Llazar Ceca, si Kryetar i Bashkisë Berat, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**